

AKT – THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"KODRA COMPANY" SHPK

Sot me daten 21/03/2023 (dymijë e njëzet e tre), unë ortakut themelues :

- **1 Znj. Suzana Kodra**, shtetase shqiptar,e datëlindjes 05 Shtator 1976, lindur dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues I Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. H65905062S

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar " KODRA COMPANY" SHPK.*

NENI 1.
EMËRTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet " KODRA COMPANY" SHPK.

NENI 2
SELIA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Hamallë,me Nr. Pasurie 44/38, Zona Kadastrale 1925 ,Durrës

NENI 3
OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Riparimi total i objekteve të ndryshme civile, turistike,shëndetësore, social - kulturore, tregtare, bujqësore,ujësjellës me kontraktues privat apo shtetëror, vendas dhe të huaj, brenda apo jashtë vendit. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e ndërtimeve civile, turistike, shëndetësore, social-kulturore,tregtare, bujqësore, ujësjellës me kontraktues privat apo shtetëror, vendas dhe të huaj, brenda apo jashtë vendit.Kryerja e të gjitha llojeve të punimeve elektrike, hidraulike në çdo lloj objekti.

NENI 4
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë " KODRA" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuota, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:



1. Suzana Kodra zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.

NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

NENI 6
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Suzana Kodra** e cila emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

NENI 7
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqërite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 8
NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9
LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.



NENI 10
MOSMARRËVESHJET

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët themelues do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË
"KODRA COMPANY" SH.P.K
SUZANA KODRA

